

## INFORMATË PËR ZONËN E MBROJTUR

### “Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshejtë”

Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshejtë është monument natyre me karakter hidro-gjeomorfologjik. Për shkak të vlerave natyrore, ky monument natyre është vënë nën mbrojtje ligjore në vitin 1986.

Meqenëse, kjo zonë ndodhet në kufirin administrativ ndërmjet territorit të komunës së Rahovecit dhe asaj të Gjakovës, kuvendet e këtyre dy komunave aso kohe janë marr vesh që njëkohësisht të marrin vendim mbi shpalljen e territoreve të tyre veç e veç si monument natyre me qëllim që monumenti si tërësi të merr trajimin e merituar.

Sipërfaqja e përgjithshme e mbrojtur në territorin e komunës Rahovec është 124.96.09 ha, prej saj në pronësi shoqërore 84.27.70 ha dhe në pronësi private 40.68.39 ha, sipas regjistrimit të mbrojtjes territori ndahet në dy zona : a) Zona e ngushtë (rigoroze) dhe b) Zona e gjerë (mbrojtëse).

Me datë 10.05.2016 është formuar grupi punues për hartimin e Arsyeshmërisë Profesionale për Kanionin e Drinit të Bardhë - Ura e Fshejtë për ri-kategorizimin e kësaj zone, me kryesues: Qenan Maxhuni nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, si dhe anëtarët: Nexhmije Kamberi, Valmira Gashi, Rihzah Murseli, Fatlije Buza, Fehmi Hoxha si përfaqësues nga Komuna e Rahovecit gjithashtu dhe Fatos Deda nga komuna e Gjakovës. Në raportin përfundimtar të propozimit vetëm anëtarët nga komuna e Gjakovës nuk e ka nënshkruar.

Grupi punues ka propozuar që kjo zonë me kufijtë e ri (fillimisht vetëm për territorin e Komunës së Rahovecit e me krijimin e rrethanave të përshtatshme edhe për atë të Gjakovës) të mbetet në kategorinë e Monumentit Natyror dhe përsëri të nxirren vendime të reja nga ana e dy komunave përkatëse për mbrojtjen e pjesëve të veta territoriale.

*Të bashkangjitur gjeni dokumentet të cilat i përmendëm më lartë.*